



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
PROKURORI I PËRGJITHSHËM

R A P O R T

PËR GJENDJEN E KRIMINALITETIT PËR VITIN 2018

Të nderuar Kryetarë të Komisioneve,
Të nderuar deputetë,

Raporti vjetor i Prokurorit të Përgjithshëm mbi gjendjen e kriminalitetit paraqitet në përmbushje të detyrimit të parashikuar nga neni 148/b shkronja “d” i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nga neni 104 i ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”.

Prokuroria ka ushtruar kompetencat e saj bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Marrëveshjet Ndërkombëtare të ratifikuara, Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale, Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur dhe ligje të tjera në fuqi, si dhe Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, rekomandimet e Këshillit të Ministrave, rekomandimet e Komisionit Evropian, prioritetëve kyçe të shtetit shqiptar në kuadër të procesit të integritetit dhe strategjinë afatmesme të prokurorisë 2018-2020.

Treguesit statistikorë të punës së prokurorisë përgjatë vitit 2018.

Gjatë vitit 2018, në organin e prokurorisë janë trajtuar **57734¹ materiale kallëzuese** që përbën një ulje prej 0,96 % në krahasim me vitin 2017.

Janë ndjekur **gjithsej 42814 procedime penale**, që përbëjnë një rritje prej rreth 5 % në krahasim me vitin 2017.

Nga këto, **31409 janë procedime penale të regjistruara të reja**, me një ulje prej 0,23 % në krahasim me vitin 2017;

486 procedime penale të rifilluara, që tregon ulje prej 23,34 % në krahasim me vitin 2017

¹ Tek kjo shifër e materialeve të trajtuara përfshihen: procedimet e mbartura nga viti 2017; procedimet e reja të regjistruara gjatë vitit 2018 për veprat penale të parashikuara në Kodin Penal dhe Kodin Penal Ushtarak; procedimet e rifilluara gjatë vitit 2018; si dhe vendimet e mosfillimit të marra gjatë vitit 2018.

Janë mbartur nga viti 2017, 10919 procedime penale.

Është vendosur **mosfillimi për 14920 referime dhe kallëzime penale**, në krahasim me 17378 mosfillime për vitin 2017 që do të thotë një ulje prej 14,15 %.

Janë **regjistruar kryesisht 109 procedime penale** nga ana e prokurorisë, në krahasim me 148 çështje të regjistruara kryesisht për vitin 2017. Pavarësisht se ka rënë pak numri i çështjeve të filluara kryesisht krahasuar me një vit më parë, duhet theksuar se ky numër nuk është i papërfillshëm. **Së pari**, fillimi i çështjeve kryesisht është një atribut i prokurorit dhe pas reformës në drejtësi, jo më i drejtuesit të prokurorisë e aq më pak i Prokurorit të Përgjithshëm, por është atribut i çdo prokurori. **Së dyti**, nuk ka një parashikim ligjor që vendos një lloj niveli apo raporti që duhet të kenë procedimet e filluara kryesisht me ato të filluara nëpërmjet referimeve. **Së treti**, viti 2018 ka qenë një vit jo i zakonshëm për të gjithë prokurorët dhe gjyqtarët. Ka filluar procesi i *vettingut*, shumë prokurorë kanë qenë gjatë gjithë vitit në kontakt të vazhdueshëm me KPK-në, nëpërmjet pyetësorëve, janë bërë shumë shkarkime. Është folur shumë për këtë dhe të gjithë kemi qenë dakord se ky proces, ka qenë i domosdoshëm, por ka qenë i pashmangshëm ndikimi negativ tek prokurorët, pasi i ka bërë apatikë dhe të pasigurt.

Në përmbledhje të këtyre treguesve, do thosha që ka një ulje të lehtë të numrit total të materialeve që ka trajtuar prokuroria shqiptare. Ky është një tregues që tregon ngarkesën e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Ulja e lehtë e këtij treguesi nuk mund të lexohet në asnjë mënyrë si rënie e treguesve të punës së prokurorisë. Prokuroria është një institucion që nuk funksionon i vetëm dhe që për nga mënyra sesi funksionon, vetëm një numër i ulët i çështjeve mund të jenë të regjistruara me iniciativën e saj. Pjesa tjetër janë produkt i referimeve nga policia e shtetit, qytetarët, institucionet e ndryshme dhe nëse referimet dhe kallëzimet kanë qenë në masë pak më të vogël, kjo nuk mund t'i faturohet vetëm prokurorisë.

Numrin më të madh të procedimeve e ka regjistruar Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë me 31 % të numrit total të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi.

Prokuroritë e tjera me ngarkesën më të lartë janë: Prokuroria e Shkallës së Parë Durrës që ka regjistruar 9 % të numrit total të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi;

Prokuroria e Shkallës së Parë Elbasan që ka regjistruar 8 % të numrit total të procedimeve të regjistruara;

Prokuroria e Shkallës së Parë Vlorë dhe Shkodër që kanë regjistruar secila, 7 % të numrit total të procedimeve të regjistruara.

Përçindja më e ulët e kriminalitetit për 100.000 banorë, vërehet në qarkun Dibër, ndërsa përçindja më e lartë në qarkun Vlorë.

Sa i përket tendencës së kriminalitetit, vërehet se rritjen më të lartë për vitin 2018 e kanë qarku Durrës e qarku Fier, ndërsa ulje e kriminalitetit vërehet në qarkun Kukës, qarkun Gjirokastër e qarkun Berat.

Sa i përket raportit mes krimeve dhe kundërvajtjeve, bazuar në statistikat e vitit 2018, rezultojnë se 83 % e procedimeve penale i përkasin krimeve dhe 17 % i përkasin kundërvajtjeve penale.

Sa i përket raportit të grup veprave sipas strukturës së Kodit Penal me numrin total të procedimeve, ndër grup veprat penale me numrin më të lartë të procedimeve të regjistruara nga ana e prokurorisë, evidentohet:

Vjedhja e pasurisë përbën numrin më të lartë të procedimeve penale të regjistruara, me 34 % të numrit të përgjithshëm të procedimeve penale të regjistruara në prokurori për vitin 2018, por me një ulje prej 2 % të numrit të procedimeve të regjistruara në krahasim me vitin 2017.

Në vijim, **veprat penale kundër rendit dhe sigurisë publike** që përbëjnë 24 % të numrit të përgjithshëm të procedimeve penale të regjistruara, e që kanë rritje me 5 % krahasuar me vitin 2017;

Veprat penale që cenojnë regjimin juridik të tokës me 5 %, por që kanë një ulje prej 29,20 % në krahasim me vitin 2017,

Veprat penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes me 4 % dhe kanë një ulje prej 8 % në krahasim me vitin 2017;

Veprat penale kundër sekretit dhe kufijve me 4 % dhe kanë një rritje të theksuar në krahasim me vitin 2017;

Falsifikimi i dokumenteve përbën 4 % të totalit të procedimeve dhe ka një ulje prej 18 % të numrit të procedimeve të regjistruara në krahasim me vitin 2017;

Krimet kundër shëndetit të krvera me dashje, krimet kundër veprimtarisë shtetërore të krvera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik, mashtrimet dhe veprat penale kundër drejtësisë, përbëjnë 3 % të numrit total të procedimeve të regjistruara në prokurori gjatë vitit 2018.

Efikasiteti

Gjatë vitit 2018 janë **përfunduar 30615 çështje** (në vitin 2017 janë përfunduar 30036 çështje).

38,5 % janë dërguar për gjykim, (rritje e konsiderueshme e numrit të çështjeve të dërguara për gjykim)

21,7 % janë pushuar (rritje e lehtë krahasuar me vitin 2017),

35,6 % janë pezulluar (ka një rënie e numrit të procedimeve të pezulluara krahasuar me vitin 2017)

dhe 4,2 % janë transferuar në prokurorinë kompetente.

Konkretisht në vitin 2018 **janë dërguar në gjykatë 11790 çështje** (në vitin 2017 janë dërguar në gjykatë 11492 çështje) me akuzë ndaj 13403 të pandehurve (në vitin 2017 janë dërguar për

grykim 12808 të pandehur). **Krahasimisht me vitin 2017 rezulton një rritje prej 2,59 % e numrit të çështjeve të dërguara në gjykatë dhe 4,65 % e numrit të të pandehurve dërguar në gjykatë.**

Në lidhje me vendimet e gjykatës, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2018 janë **dënuar 10246 të pandehur dhe për 211 të pandehur është dhënë vendim për deklarimin të pafajshëm** (në vitin 2017 janë dhënë vendime pafajësie për 338 të pandehur, ndërkohë në grykim kanë qenë dërguar 12808 të pandehur).

Gjatë vitit 2018 është kërkuar **grykimi i drejtpërdrejtë për 315 çështje me 318 të pandehur.**

I janë dërguar gjykatës **591 kërkesa për miratim të urdhrit penal** në lidhje me 619 të pandehur dhe në 43 raste është vendosur refuzimi i miratimit të urdhrit penal. (në vitin 2017 janë dërguar 255 kërkesa për miratim të urdhrit penal dhe 29 janë refuzuar nga gjykata)

I janë dërguar gjykatës **570 kërkesa për miratim të marrëveshjes së fajësisë** në lidhje me 621 të pandehur dhe në 38 raste është vendosur refuzimi i miratimit të marrëveshjes. (në vitin 2017 janë dërguar në gjykatë 356 kërkesa për miratim të marrëveshjes së fajësisë dhe në 10 raste është vendosur refuzimi i miratimit të marrëveshjes)

Gjatë vitit 2018, **u dërguan në gjykatë për pushim 2605 çështje.** Nga të dhënat rezulton se në 169 çështje gjykata vendosi kthimin e akteve dhe vazhdimin e hetimeve ndërsa në 12 çështje vendosi kthimin e akteve dhe urdhërimin e formulimit të akuzës. (në vitin 2017 janë dërguar në gjykatë me kërkesë për pushim 1371 çështje, në 27 çështje është vendosur kthimi i akteve dhe vazhdimi i hetimeve. Në 4 çështje është vendosur kthimi i akteve dhe formulimi i akuzës).

Rezoluta e Kuvendit dhe mënyra se si ajo është zbatuar.

Në përfundim të raportimit të veprimtarisë së prokurorisë për vitin 2017, Kuvendi i Shqipërisë miratoi një rezolutë duke vlerësuar veprimtarinë e prokurorisë për vitin e raportimit dhe duke i përcaktuar prokurorisë disa detyra për vitin 2018.

Sipas rezolutës, Kuvendi i ka kërkuar Prokurorisë që për vitin 2018 të realizojë:

- **Rritjen e numrit të hetimeve në tërësi dhe në vecanti e hetimeve proaktive kundër krimit të organizuar, korrupsionit në nivel zyrtarësh të lartë dhe të mesëm, funksionarëve të sistemit të drejtësisë, të zgjedhurve në nivel qendror dhe vendor.**

Lufta kundër korrupsionit, krimit të organizuar, trafikëve e krimeve të tjera të rënda, edhe për vitin 2018 kanë qenë prioritete të aktivitetit tonë institucional. Për arritjen e rezultateve ndaj tyre, objektiv i rëndësishëm i yni ka qenë forcimi i bashkëpunimit ndër-institucional me autoritetet vendase dhe të huaja, si në nivel operacional, ashtu dhe nëpërmjet trajtimit dhe përgjigjes në kohë e në mënyrë efikase të letër kërkesave të autoriteteve të huaja.

Në funksion të zbatimit të planit të veprimit për luftën kundër krimit të organizuar, **Prokurori i Përgjithshëm ka miratuar udhëzimin nr.1, dt.20.02.2018 “Për krijimin e seksioneve të posaçme”**, në PKR dhe disa prokurori të tjera. Efekti i këtij udhëzimi dhe i seksioneve të krijuara, do pasqyrohet në vazhdim për një kategori veprash penale që lidhen me krimin e organizuar.

Sipas të dhënave statistikore evidentohet se ka një ulje prej 37 % të numrit në total të procedimeve të regjistruara për veprat penale të korrupsionit.

Numrin më të lartë në procedimet e regjistruara për veprat penale të korrupsionit për vitin 2018 e zë vepra penale “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, e parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal, e konkretisht në masën 43 % të tyre, ndërsa për vitin 2017 kjo vepër përbënte 22 % të totalit të procedimeve për korrupsion. **Procedimet e regjistruara për këtë vepër janë rritur nga 61 procedime në vitin 2017, në 74 procedime në vitin 2018 ose me rritje 21 % të procedimeve të regjistruara.**

Në lidhje me ushtrimin e ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike, treguesit janë pothuajse të njëjtë me vitin 2017, 24 çështje të regjistruara për vitin 2017 dhe 23 çështje të regjistruara për vitin 2018.

Në lidhje me korrupsionin në sistemin e drejtësisë gjatë vitit 2018, janë regjistruar 3 procedime penale për nenin 319 të Kodit Penal dhe 29 procedime penale janë regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal, ndërsa 2 procedime për këtë vepër janë dërguar për gjykim. Ndërsa në vitin 2017 për veprën penale të parashikuar nga neni 319 i Kodit Penal “Korrupsioni aktiv i gjyqtarëve, prokurorëve, dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, prokuroria ka regjistruar 1 procedim penal dhe për veprën penale të parashikuar ne nenin 319/ç të Kodit Penal “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve, dhe zyrtarëve të tjerë të drejtësisë”, prokuroria ka regjistruar 14 procedime penale, ndërkohë 1 çështje penale është dërguar në gjykatë. **Pra ka përmirësim të treguesve të ndjekjes penale edhe për këtë kategori të veprave penale të korrupsionit.**

Për veprat penale të korrupsionit aktiv e pasiv të funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë, gjatë vitit 2018 janë regjistruar 3 procedime për nenin 245, njësoj me vitin 2017, si dhe 6 procedime për nenin 260, kundrejt 13 procedimeve të regjistruara për vitin 2017. Ka një ulje të lehtë të treguesve.

Përsa i përket korrupsionit aktiv të personave që ushtrojnë funksione publike, vepër e parashikuar nga neni 244 i K. Penal, për vitin 2018 janë regjistruar 29 procedime (24 në gjykim) kundrejt 124 procedimeve të regjistruara një vit më parë (106 procedime të dërguara në gjykatë).

Duke i analizuar këta tregues objektivisht, mund të themi që është ulur numri i çështjeve të regjistruara krahasuar me një vit më parë, por për korrupsionin pasiv të funksionarëve të lartë dhe për korrupsionin e funksionarëve të drejtësisë, është rritur numri i çështjeve në hetim dhe ai i çështjeve të dërguara për gjykim.

Në zbatim të detyrimit që rrjedh nga Rezoluta, lidhur me rritjen e hetimeve proaktive për veprat penale kundër korrupsionit, **gjatë vitit 2018 janë kryer hetime proaktive dhe me përdorim të teknikave të posaçme të hetimit në kuadrin e 93 procedimeve penale**, ndërkohë 30 procedime i përkasin prokurorisë për krime të rënda dhe 63 procedime i përkasin prokurorive të tjera ose krahasuar me vitin 2017 me shifra në rritje 14,4 %. Kjo veprimtari ka shërbyer në ndalimin e 73 personave (të arrestuar në flagrancë apo ndaluar) si të dyshuar për përfshirjen në kryerjen e veprave penale, të korrupsionit dhe të shpërdorimit të detyrës, ndërkohë 14 persona/autorë të dyshuar i përkasin kompetencës të prokurorisë për krime të rënda dhe 59 persona/autorë të dyshuar, në kompetencë të prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm.

Ndërkohë, **janë filluar kryesisht nga prokuroria 21 çështje për vepra që lidhen me abuzimin me funksionin publik, ku peshën kryesore e përbëjnë procedimet që lidhen me shpërdorimin e detyrës, për të cilën janë filluar kryesisht 8 çështje, korrupsioni pasiv i funksionarëve të sistemit të drejtësisë për të cilët janë filluar kryesisht 5 çështje dhe korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike, për të cilët janë filluar kryesisht nga prokurori 4 çështje.**

Vlen të theksojmë se të gjitha prokuroritë janë njohur me rezolutën e Kuvendit dhe me planin e veprimit të hartuar nga Prokurori i Përgjithshëm në zbatim të saj. Gjatë takimeve periodike me drejtuesit e prokurorive dhe gjatë analizave vjetore është bërë prezent gjithmonë mungesa e referimeve nga policia e shtetit për këtë vepër penale. Ky problem është diskutuar prej tyre edhe me zyrtarë të policisë nëpër rrethe. Veprat penale të korrupsionit janë të tilla që institucionet duhet të rakordojnë veprimet dhe të bëhet një hetim proaktiv. Nuk mund të hetohet korrupsioni me hetim historik, post faktum. Kështu që më duhet t'ju transmetoj shqetësimin e prokurorëve për mungesë të referimeve për këto vepra dhe thjesht këtë po bëj. Nuk po ngarkoj me përgjegjësi institucione të tjera. Por të gjithë e dimë, se jemi juristë, që një çështje e suksesshme për vepra të tilla penale nuk mund të bëhet pa një referim të mirë dhe në kohën e duhur dhe duke përdorur metodat speciale të hetimit. Mesa duket, në hetimin e këtyre veprave, institucionet nuk kanë arritur të kenë sukses të dukshëm. Megjithatë, ky është një problem i njohur dhe kjo ka qenë dhe arsyeja e bërjes së reformës në drejtësi dhe e parashikimit për ngritjen e institucioneve të reja që do luftojnë këtë fenomen, në nivel prokurorie, gjykate dhe policie gjyqësore.

Megjithatë, pavarësisht të gjithave, sic ju referova më lart, ka pasur hetime proaktive, çështje të filluara kryesisht, si dhe përmirësim të treguesve të paktën për dy prej veprave penale kundër korrupsionit.

Sa i përket treguesve statistikorë për veprat penale të krimit të organizuar, për vitin 2018, rezulton se janë regjistruar 41 procedime për veprën penale që parashikon nenin 333/a, “Grupi i strukturuar kriminal”, ndërkohë 6 procedime penale janë dërguar në gjykatë ose krahasuar me vitin 2017 **me rritje rreth 2,5 herë të numrit të procedimeve të regjistruara për këtë vepër penale**. Në vitin 2017, për këtë vepër kanë qenë regjistruar vetëm 16 procedime. Numri i të pandehurve të dënuar për këtë vepër është 51, ndërkohë në vitin 2017 ky numër ishte 30.

Lidhur me trafikun e qenieve njerëzore, në vitin 2018 për veprën penale “Trafikimi i personave të rritur” të parashikuar nga neni 110/a i Kodit Penal janë regjistruar 17 procedime penale, ndërkohë 1 procedim është dërguar për gjykim ose krahasuar me vitin 2017 **me ulje prej 29 %** të numrit të procedimeve të regjistruara (në 2017, 24 procedime, 2 në gjykim).

Ndërsa, për veprën penale “Trafikimi i të miturve” të parashikuar nga neni 128/b i Kodit Penal, janë regjistruar 5 procedime penale, ndërkohë 1 procedim penal është dërguar për gjykim, ose krahasuar me vitin 2017 **me ulje 16 %** e numrit të procedimeve të regjistruara (në 2017 6 procedime, 3 në gjykim)

Sa i përket “Trafikimit të armëve dhe municionit” të parashikuar nga neni 278/a i Kodit Penal, në vitin 2018 janë regjistruar 11 procedime penale, ndërkohë 3 procedime janë dërguar për gjykim ose krahasuar në vitin 2017 **me rritje rreth 2 herë të numrit të procedimeve të regjistruara për këtë vepër penale** (në 2017, 5 procedime dhe asnjë nuk është dërguar në gjykim).

Në lidhje me luftën kundër terrorizmit të dhënat statistikore të vitit 2018, për veprën penale “Financimi i terrorizmit” të parashikuar nga neni 230/a i Kodit Penal janë regjistruar 4 procedime penale, ndërkohë në vitin 2017 janë regjistruar 3 procedime.

- **Rritjen e numrit të hetimeve proaktive për veprat penale të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, trafikimi i narkotikëve dhe kultivimi i bimëve narkotike.**

Në zbatim të detyrimit që rrjedh nga Rezoluta për rritjen e numrit të hetimeve proaktive për veprat penale në fushën e narkotikëve, gjatë **vitit 2018 janë kryer hetime proaktive dhe me përdorim të teknikave të posaçme të hetimit në kuadrin e 250 procedimeve penale**, ndërkohë 104 procedime i përkasin prokurorisë për krime të rënda dhe 146 procedime i përkasin prokurorive të tjera. Kjo veprimtari ka shërbyer në parandalimin e 275 personave të arrestuar në flagrancë apo ndaluar si të dyshuar për përfshirjen në kryerjen e veprave penale në fushën e narkotikëve, ndërkohë 151 persona/autor të dyshuar i përkasin kompetencës të prokurorisë për krime të rënda dhe 124 persona/autor të dyshuar në kompetencë të prokurorive pranë gjykatëve të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm.

Të dhënat statistikore lidhur me veprat penale në fushën e narkotikëve në vitin 2018 tregojnë se:

Për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, të parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal janë regjistruar 1127 procedime, ndërkohë 447 procedime janë dërguar në gjykatë ose krahasuar me vitin 2017 me ulje të numrit të procedimeve të regjistruara dhe atyre të dërguara për gjykim (për vitin 2017 kanë qenë regjistruar për këtë vepër 1193 procedime dhe nga këto 596 kanë qenë dërguar për gjykim)

Për veprën penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, të parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal janë regjistruar 292 procedime penale, ndërkohë 46 procedime janë dërguar për gjykim ose

krahasuar me vitin 2017 me ulje të numrit të procedimeve të regjistruara dhe të atyre të dërguara për gjykim (për vitin 2017 kanë qenë regjistruar për këtë veper 375 procedime dhe nga këto 134 kanë qenë dërguar për gjykim)

Lidhur me veprën penale “Trafikimi i narkotikëve”, të parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal, në vitin 2018, janë regjistruar 105 procedime penale, ndërkohë janë dërguar në gjykatë 39 procedime ose krahasuar me vitin 2017 me ulje të numrit të procedimeve të regjistruara për këtë veper dhe të atyre të dërguara për gjykim. (për vitin 2017 kanë qenë regjistruar për këtë veper 196 procedime dhe nga këto 79 kanë qenë dërguar për gjykim)

Në përmbushje të funksioneve Kushtetuese e Ligjore dhe në zbatim të Rezolutës për këtë tregues, e konsiderojmë të zbatuar detyrimin për faktin se në uljen në tërësi të numrit të procedimeve të regjistruara për këto grup veprash, kanë ndikuar si masat e marra në kuadrin e bashkëpunimit ndërinstucional në nivel qendror dhe vendor në luftën kundër kultivimit dhe trafikimit të narkotikëve, ashtu dhe efektet parandaluese, si nga sekuestrimi i sasive të konsiderueshme të drogës së kultivuar dhe të kapur gjatë vitit 2018, ashtu dhe goditja e vazhdueshme e veprimtarisë kriminale në këtë fushë.

- **Rritjen e numrit të hetimeve pasurore për identifikimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive, mjeteve dhe produkteve të veprave penale me origjinë kriminale e organizuar, sipas ligjit antimafia.**

Sa i përket zbatimit të ligjit “Antimafia”, nr.10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe Goditjen e Krimin të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”, i ndryshuar, **për vitin 2018, janë trajtuar 774 raste të hetimit pasuror** nga të cilët, për 13 referime pasurore është vendosur mosfillimi, ndërsa pjesa tjetër e materialeve pasurore janë mbartur për vitin 2019.

Për vitin 2017, organi i akuzës ka paraqitur në gjykatë 4 kërkesa për sekuestrim pasurie dhe 7 kërkesa për konfiskim pasurie.

Paraprakisht më duhet t’ju them se në momentin e përpilimit të raportit vjetor, prokuroritë e rretheve dhe prokuroria për krime të rënda nuk kishin dërguar ende informacionin për hetimet pasurore dhe për këtë arsye, duke qenë se Prokuroria e Përgjithshme është vetëm mbledhëse dhe pasqyruese e të dhënave dhe jo përpunuese e tyre, janë pasqyruar ashtu sic janë sjellë. Gjatë hedhjes së të dhënave është konstatuar se nuk janë të sakta dhe janë rikërkuar të detajuara. Kështu që treguesit që do ju prezantoj nuk përputhen me raportin, por do ua vëmë në dispozicion korrigjimet e bëra.

Për të orientuar prokurorët në praktikë dhe duke vlerësuar si shumë të rëndësishëm veprimtarinë e prokurorisë në drejtim të hetimit pasuror, **Prokurori i Përgjithshëm ka miratuar Udhëzimin nr. 6, datë 20.11.2018 “Për hetimin pasuror, sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të veprës penale”**. Është mbikëqyrur zbatimi i këtij udhëzimi në praktikë dhe ka rezultuar se si prokuroritë e rretheve, ashtu dhe prokuroria për krime të rënda e kanë zbatuar atë duke përmirësuar ndjeshëm edhe mbajtjen e të dhënave statistikore. Nga

nxjerrja e udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm e deri sot, janë regjistruar 162 referime pasurore të reja.

Konkretisht, treguesit për hetimet pasurore, qoftë të lidhura me procesin penal, qoftë në zbatim të ligjit Antimafia, gjatë vitit 2018 dhe deri aktualisht janë të tillë:

26 kërkesa për sekuestrim të pasurive, si pjesë e procesit penal. Pasuria e sekuestruar është në vlera monetare, apartamente, troje, sipërfaqe tokash, automjete etj. Në shumë raste pasuria e sekuestruar është vlerësuar, por në disa raste të tjera vlerësimi është në proces. Me përafërsi, vlera e pasurive të sekuestruara **është rreth 3 miliard lekë, 12 milion euro, 91 mijë paund, 270 mijë dollarë, 80 mijë franga, si dhe qindra ha tokë, dhjetëra ndërtesa e automjete.**

5 kërkesa për konfiskim pasurie në funksion të procedimit penal. Pasuritë e konfiskuara janë troje, ndërtesa, qindra hektarë tokë.

2 kërkesa për konfiskim pasurish sipas ligjit antimafia. Pasuritë e sekuestruara janë në proces vlerësimi dhe konsistojnë në vila, apartamente, troje, automjete, si dhe një sasi prej rreth 13 milion lekë.

1 kërkesë për konfiskim sipas ligjit antimafia. Vlera e pasurisë për të cilën është kërkuar sekuestrimi është rreth 3 milion euro. Kërkesa është në proces gjykimi.

- **Garantimin e ndihmës në procesin e rivlerësimit kalimtar të prokurorëve, duke bashkëpunuar ngushtësisht me organet e reja që priten të krijohen, Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, në procesin e vlerësimit profesional dhe hetimin disiplinor të prokurorëve.**

Prokuroria e Përgjithshme dhe prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë dhe të apeleve janë angazhuar maksimalisht dhe kanë përmbushur detyrimet ligjore për të ndihmuar në përshpejtimin e procesit të rivlerësimit profesional të prokurorëve në kuadër të rivlerësimit kalimtar të tyre. Në zbatim të nenit 43 e vijues të ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe të neneve 160 pika 2 shkronja “d”, 171 pika 4 e vijues të ligjit nr.96/2017 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” në prokuroritë e të gjitha niveleve janë marrë të gjithë masat e nevojshme për të siguruar/garantuar ndihmën për organet e rivlerësimit në përmbushjen e detyrave të tyre në procesin e vlerësimit profesional të subjekteve të rivlerësimit.

Në vitin 2018, prokurorët e grupit të punës në Prokurorinë e Përgjithshme dhe drejtuesit e prokurorive përkatëse janë angazhuar në procedurën e hedhjes së shorteve nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në përzgjedhjen e çështjeve për vlerësimin profesional **të 118 prokurorëve e drejtuesve të prokurorive.** Kështu, deri në 28 dhjetor 2018 ka përfunduar shorti për vlerësimin profesional për prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme, drejtuesit e prokurorive të apeleve dhe drejtuesit e prokurorive të shkallës së parë, Drejtuesit dhe Prokurorët e Prokurorisë së Apelit për Krime të Rënda, prokurorët e Prokurorisë për Krime të Rënda, prokurorët e Prokurorive të Apeleve Tiranë, Shkodër, Durrës, Gjirokastër e Korçë dhe

prokurorët e Prokurorive të Rretheve Gjyqësore Sarandë, Gjirokastrë, Përmet, Kavajë, Kurbin, Tropojë, Pukë, Kukës, Burrel e Dibër, si dhe pjesërisht (shorti) për prokurorët në Prokuroritë e Shkallës së Parë Tiranë, Shkodër, Krujë e Vlorë.

Prokuroritë e të gjitha niveleve, krahas ngarkesës së punës në ushtrimin e funksioneve të tyre, kanë koordinuar me shpejtësi e korrektësi me Grupin e Punës të ngritur në Prokurorinë e Përgjithshme për dërgimin e informacioneve dhe dosjeve për vlerësimin profesional të secilit prokuror, drejtues apo zëvendësdrejtues të shortuar.

Grupi i punës në Prokurorinë e Përgjithshme **ka dorëzuar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit gjithësej 83 raporte të vlerësimit profesional të subjekteve prokuror/drejtues të rivlerësimit kalimtar.** Në dhjetor 2018 me krijimin dhe konstituimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë (në vijim KLP) 35 praktika në proces ndjekje me prioritet në grupin e punës të Prokurorisë së Përgjithshme janë dërguar/transferuar për kompetencë në Këshill për hartimin e raporteve të vlerësimit profesional të subjekteve prokuror/drejtues të rivlerësimit kalimtar.

Aktualisht, në procesin e rivlerësimit kalimtar kanë kaluar dhe janë konfirmuar në detyrë 19 prokurorë, ndërsa për 21 prokurorë është vendosur shkarkimi nga detyra, prej të cilëve 15 prokurorë janë të pezulluar në pritje të shqyrtimit të ankimit tyre në Kolegjin e Posaçëm të Apelit (KPA).

Në kuadrin e kësaj veprimtarie të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve/prokurorëve dhe në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.188 datë 04.03.2015 “*Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit*” prokurorët në Prokurorinë e Përgjithshme dhe në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë janë angazhuar edhe me kryerjen e verifikimeve të nevojshme për kërkesat e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK), duke iu dërguar përgjigje/informacione për subjektet përkatëse.

Në kuadrin e ngritjes së organeve të reja të sistemit të drejtësisë dhe parapërgatitjes së procesit të zgjedhjes së anëtarëve prokurorë për Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Prokurori i Përgjithshëm me urdhrin nr.68, datë 23.02.2018 ngriti grupin e punës për hartimin e projektregullores për procesin e votimit për zgjedhjen e anëtarëve të komisionit të votimit dhe projekturdhrit për miratimin e fletës tip të votimit në përputhje me ligjin nr.115/2016 “*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*”. Këto akte u përgatitën në bashkëpunim me ekspertët e Projektit EURALIUS, dhe rregullorja iu propozua për miratim Mbledhjes së Përgjithshme të prokurorëve.

Në këtë kuadër, në përfundim të procesit të rivlerësimit kalimtar të prokurorëve/ kandidatëve, më datë 11 dhjetor 2018, Prokurori i Përgjithshëm thirri dhe organizoi Mbledhjen e Përgjithshme të prokurorëve, e cila miratoi Rregulloren që i shërbeu realizimit të një procesi transparent dhe korrekt votimi për përzgjedhjen e kandidatëve. Në përfundim, Komisioni i Votimit shpalli fitues 6 anëtarët prokurorë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, zgjedhja e të cilëve mundësoi krijimin e këtij organi/institucioni të rëndësishëm kushtetues të qeverisjes së prokurorëve që garanton pavarësinë, llogaridhënien, disiplinën, statusin dhe karrierën e tyre.

Në përmbushje të detyrave Kushtetuese e Ligjore dhe në zbatim të rekomandimit të Rezolutes më sipër, rezulton se është zbatuar detyrimi i Rezolutës për garantimin e ndihmës në procesin e rivlerësimit kalimtar të prokurorëve, duke kontribuar për ngritjen e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, me zgjedhjen e anëtarëve nga radhët e prokurorëve.

- **Përdorimin e instituteve procedurale, si urdhri penal, marrëveshja e fajësisë, gjykimi i drejtpërdrejtë në mënyrë efektive, për t'i shërbyer shpejtësisë së procesit dhe qëllimit të ligjit penal.**

Për zbatimin e instituteve të reja procedurale penale të miratuara me ligjin nr.35/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin e Procedurës Penale”, të hyra në fuqi më datë 1 Gusht 2017, Prokuroria e Përgjithshme në bashkëpunim me OPDAT-in, më datë 10 Korrik 2018 ka organizuar një takim pune me gjithë drejtuesit e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm me qëllim diskutimin teorik të këtyre instituteve dhe nxitjen e prokurorëve për një aplikim sa më të gjerë të tyre.

Duhet theksuar se në krahasim me një vit më parë, treguesit për këto institute të reja procedurale janë përmirësuar ndjeshëm duke u dyfishuar treguesit. Janë bërë të gjitha përpjekjet, sipas kompetencave që ligji i jep Prokurorit të Përgjithshëm, për të nxitur prokurorët në përdorimin e këtyre instituteve dhe treguesit duket qartë se janë në rritje. Kuvendi me rezolutën e tij ka kërkuar që këto institute të reja të përdoren dhe të dhënat tregojnë për një dyfishim të përdorimit të tyre që nuk mund të konsiderohet i papërfillshëm. Prokurorët, avokatët mbrojtës po i njohin gradualisht këto institute dhe po i bëjnë pjesë të praktikës së tyre.

- **Forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar me agjencitë e huaja ligjzbatuese, me qëllim luftën ndaj krimit të organizuar dhe veprave penale që lidhen me pastrimin e parave, si dhe marrjen e masave për adresimin e problematikave që konstatohen nga Progresraporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë dhe Raporti i Departamentit të Shtetit të SHBA-së, lidhur me problematikat e krimit të organizuar në Shqipëri.**

Në kuadër të marrëdhënieve juridiksionale me jashtë dhe bashkëpunimit me agjencitë ligjzbatuese rajonale dhe ndërkombëtare në funksion të efektivitetit të hetimeve për grupet e strukturuar kriminale, **Prokurori i Përgjithshëm miratoi udhëzimin nr. 2, datë 18.06.2018 me synim për të përmirësuar koordinimin e informacionit dhe ndjekjen e tij në çështjet e ekstradimit për jashtë.** Në kuadrin e këtij bashkëpunimi, të dhënat statistikore për periudhën Janar – Dhjetor 2018, evidentojmë se janë trajtuar 1856 kërkesa nga jashtë dhe për jashtë shtetit. Konkretisht:

- Ekstradime nga jashtë - 171 subjekte²;
- Ekstradime për jashtë - 128 subjekte;

² Të pandehur ose të dënuar me vendim penal të formës së prerë.

- Letërporositë nga jashtë - 668 letërporosi;
- Letërporositë për jashtë - 782 letërporosi;
- Njohjet e vendimeve penale të huaja - 48 kërkesa;
- Njohjet e vendimeve penale shqiptare jashtë vendit - 11 kërkesa;
- Transferimet e procedimeve nga jashtë - 20 raste;
- Transferimet e procedimeve për jashtë - 14 procedime penale;
- Transferimet e personave të dënuar nga jashtë - në 4 raste;
- Transferimet e personave të dënuar për jashtë - 10 raste.

Gjatë vitit 2018 prokuroria, gjithashtu ka shpallur në kërkim ndërkombëtar gjithsej 256 subjekte dhe ka kërkuar që Zyra Qendrore Kombëtare Interpol Tirana të procedojë me heqjen e 63 subjekteve nga listat e kërkimit ndërkombëtar.

Vlerësojmë të theksojmë se, Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme, krahas volumit të punës të trajtuar specifikisht sipas fushave të mësipërme të bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar, gjatë vitit 2018 ka trajtuar në kohë reale edhe 401 kërkesa të ndryshme të ardhura nga autoritetet gjyqësore vendase dhe ato të huaja.

Në kuadër të paraqitjes së kërkesave nga autoritetet e huaja për ekstradimin e shtetasve nga Shqipëria drejt shteteve kërkuese apo për njohjen dhe ekzekutimin në Shqipëri të vendimeve penale të huaja të dhëna ndaj shtetasve shqiptarë, theksojmë se, **Prokuroria e Përgjithshme gjatë vitit 2018 i ka përcjellë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda 30 raste, për zbatimin e masave parandaluese kundër pasurisë së këtyre shtetasve**, brenda objektit të nenit 3, pika 1/d (*fusha e zbatimit*) dhe nenin 8/1 (*verifikimet paraprake*) të ligjit nr.10192, datë 03.12.2009, “*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*”.

Rëndësi e veçantë i është kushtuar edhe krijimit të marrëdhënieve të ngushta të bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë.

Në datë 28.04.2018 u nënshkrua një Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë dhe Autoritetit Suedez të Prokurorisë, ku synohet bashkëpunimi në fushën e drejtësisë penale për të miturit, përfshirë rishikim/zbatim legjislativ, mekanizma dhe struktura organizative, forcim i kapaciteteve: trajnim dhe udhëzime.

Në datë 26.09.2018 u nënshkrua në Sofje, Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Prokurorisë së Republikës së Bullgarisë dhe Prokurorisë së Republikës së Shqipërisë.

Në maj 2018, Republika e Shqipërisë ka miratuar në parim marrëveshjen e bashkëpunimit midis Republikës së Shqipërisë dhe EUROJUST-it. Duke qenë se Prokuroria e Përgjithshme është autoriteti që në bazë të marrëveshjes ka për detyrë zbatimin e saj, theksojmë se jemi në këtë fazë:

1. *Prokuroria e Përgjithshme dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale kanë nënshkruar më 25.02.2019 një Plan Veprimi me qëllim marrjen e masave për zbatimin e Marrëveshjes me EUROJUST, dhe përcaktimit të veprimeve konkrete që do të ndërmerren për këtë qëllim, duke përcaktuar dhe afate kohore. Plani i Veprimit është Shtojcë e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Prokurorisë së Përgjithshme nënshkruar më 18.05.2012.*
2. *Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në bashkëpunim me Prokurorinë e Përgjithshme duke filluar nga muaji Prill i vitit 2019 po organizon takime konsultuese/monitoruese (vlerësuese) në Prokurorinë e Përgjithshme, Prokurorinë e Tiranës dhe Prokurori të tjera, specifikisht në Prokuroritë e Durrësit, Elbasanit, Vlorës, Shkodrës, Korçës dhe Gjirokastrës, me qëllim vlerësimin e proceseve përpunuese të të dhënave personale, evidentimin e nivelit të zbatimit të detyrimeve në kuadër të legjislacionit shqiptar dhe standardeve ndërkombëtare për mbrojtjen e të dhënave personale dhe evidentimin e mangësive.*
3. *Zyra e Komisionerit do të asistojë Prokurorinë e Përgjithshme në ngritjen e një regjistri për komunikimet me EUROJUST, ngritja e të cilit do të bëhet me urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm dhe është gati.*
4. *Komisioneri në bashkëpunim me Prokurorinë e Përgjithshme do të zhvillojnë disa trajnime të përgjithshme në ambientet e Prokurorisë së Përgjithshme dhe në 3 prokurori kryesore në nivel qarku specifikisht në Tiranë, Durrës dhe Korçë. Trajnimet do të fokusohen mbi detyrimet që parashikon legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale dhe masat konkrete që duhen marrë në kuadër të implementimit të marrëveshjes me EUROJUST. Trajnimet do të synojnë të reflektojnë gjithashtu gjetjet dhe rekomandimet e Komisionerit të dhëna si rezultat i takimeve vlerësuese të zhvilluara më parë. Trajnimet duhet të kenë përfunduar deri në fund të muajit Maj 2019.*

Veç sa më sipër, **gjatë vitit 2018 janë nënshkruar 3 marrëveshje për ngritjen e grupeve të përbashkëta hetimore ndërmjet Italisë dhe Shqipërisë**, në kuadër të çështjeve penale të regjistruara për veprën penale të “*Organizatës kriminale me qëllim trafikimin e lëndëve narkotike*”. Objekti i veprimtarisë së skuadrave të përbashkëta hetimore, përfshin kryerjen e veprimeve hetimore në territoret e dy Shteteve Palë të Marrëveshjes, ndër të cilat përmenden:

- Identifikimi i aktiviteteve dhe strukturave të organizatave kriminale;
- Identifikimi i roleve përkatëse të anëtarëve të organizatës, furnizuesve të lëndëve narkotike dhe pritësve të tyre;
- Identifikimi i vendeve të kultivimit dhe depozitimit të lëndëve narkotike si dhe mjetet dhe mënyrat e përgatitjes dhe maskimit/fshehjes;
- Verifikimi i mënyrës së transportit dhe gatishmërisë së mjeteve që përdoren për transportin e tyre;
- Verifikimi i ekzistencës së financuesve eventualë të trafikut të lëndëve narkotike si dhe mënyrat e ri investimit të të ardhurave të mëdha të siguruara, duke treguar dhe emra përkatës.

Gjithashtu është në proces nënshkrimi një marrëveshje e katërt për ngritjen e një skuadre të përbashkët hetimore me Italinë, e cila do të koordinohet nga Eurojust-i. Po kështu, dy nga skuadrat e cituara më lart janë ngritur dhe do të realizojnë aktivitetet e miratuara me mbështetjen e Eurojust-it.

Përveç sa më sipër, me mbështetjen e Misionit EURALIUS në Prokurorinë e Përgjithshme është ngritur grup pune për hartimin e një udhëzimi të përgjithshëm në lidhje bashkëpunimin gjyqësor ndërkombëtar në fushën e krimit kibernetik.

- **Ashpërsimin e politikës penale për masat e sigurisë dhe të dënimit kundër: krimit të organizuar, korrupsionit, dhunës në familje, krimeve kundër jetës, pastrimit të parave, krimit ekonomik dhe financiar, armëmbajtjes pa leje, krimit që lidhet me procesin zgjedhor, personave përsëritës në krim, krimit mjedisor.**

Prokuroria gjatë vitit 2018 ka ndjekur një **politikë të ashpër penale** për të pandehurit që dyshohen për **kryerjen e veprave penale të krimit të organizuar** dhe kjo pasqyrohet në të dhënat konkrete lidhur me kërkesat për masat e sigurimit personal, ku **99,5 % janë kërkesa për caktimin e masës të sigurimit “arrest në burg”** dhe në kërkesat e prokurorit për caktimin e llojit dhe masës së dënimit, ku të gjitha janë për caktimin e dënimit me burg, prej të cilave: **92 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita**, 3 % në maksimumin e dënimit të parashikuar nga dispozita dhe 5 % e kërkesave për caktimin e dënimit me burgim të përjetshëm.

Gjatë vitit 2018 për personat e dyshuar dhe/ose të akuzuar **për kryerjen e veprave penale korruptive, kërkesat e prokurorit për caktimin e masave të sigurimit personal 80 % janë për caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”**, ndërsa kërkesat e prokurorit për caktimin e llojit dhe masës së dënimit, në masën **49 % janë për caktimin e dënimit me burgim** dhe në masën 51 % për caktimin e dënimit alternativ të dënimit me burgim.

Gjatë vitit 2018 për personat e dyshuar dhe/ose të akuzuar **për kryerjen e veprave penale kundër jetës të kryera me dashje, 91 % e kërkesave të prokurorit për caktimin e masave të sigurimit personal, janë për caktimin e masave të sigurimit me arrest**, ndërsa kërkesat e prokurorit për caktimin e llojit dhe masës së dënimit, në masën 10 % janë për caktimin e dënimit me gjobë, në masën 10 % janë për caktimin e dënimit me burgim në minimumin e dënimit të parashikuar nga ligji për veprën penale konkrete, **41 % janë për caktimin e dënimit me burgim në marzhin mesatar**, 28 % janë për caktimin e dënimit me burgim në maksimumin e dënimit të parashikuar nga ligji për veprën penale konkrete, 7 % e kërkesave është për caktimin e burgimit të përjetshëm dhe 4 % e tyre për caktimin e dënimit alternativ të dënimit me burgim.

Sa i përket kërkesave për caktimin e llojit dhe masës së dënimit për veprën penale të vrasjes për shkak të marrëdhënieve familjare, nga prokurorët është kërkuar në 3 raste burgim i përjetshëm, në 3 raste burgim në maksimumin e marzheve me burgim të parashikuar nga ligji për këtë veprë, në 1 rast burgim në mesataren e marzheve. Ndërsa në rastet kur këto vepra

penale kanë mbetur në fazën e tentativës, në 3 raste është kërkuar caktimi i dënimit me burgim në minimumin e marzheve me burgim të parashikuar nga ligji për këtë veprë.

Sa i përket politikës penale, **për dhunën në familje prokurorët në 85,6 % të numrit të personave të dyshuar/akuzuar për kryerjen e kësaj vepre penale kanë kërkuar caktimin e masave të sigurimit personal “arrest në burg”.**

Gjatë vitit 2018 për personat e dyshuar dhe/ose të akuzuar **për kryerjen e veprave penale të armëmbajtjes pa leje, 82 % e kërkesave të prokurorit për caktimin e masave të sigurimit personal, janë për caktimin e masave të sigurimit me arrest,** ndërsa kërkesat e prokurorit për caktimin e llojit dhe masës së dënimit, në masën 12 % janë për caktimin e dënimit me gjobë, në masën 11 % janë për caktimin e dënimit me burgim në minimumin e dënimit të parashikuar nga ligji për veprën penale konkrete, **50 % janë për caktimin e dënimit me burgim në marzhin mesatar,** 1 % janë për caktimin e dënimit me burgim në maksimumin e dënimit të parashikuar nga ligji për veprën penale konkrete dhe në masën 26 % për caktimin e dënimit alternativ të dënimit me burgim.

Gjatë vitit 2018 për personat e dyshuar dhe/ose të akuzuar **për pastrim të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, 80 % e kërkesave të prokurorit për caktimin e masave të sigurimit personal, janë për caktimin e masave të sigurimit me arrest,** ndërsa kërkesat e prokurorit për caktimin e llojit dhe masës së dënimit, në masën 22 % janë për caktimin e dënimit me burgim në minimumin e parashikuar nga ligji, në masën **34 % janë për caktimin e dënimit me burgim në marzhin mesatar të dënimit,** në masën 14 % janë për caktimin e dënimit me burgim në maksimumin e dënimit të parashikuar nga ligji për veprën penale dhe në masën 30 % për caktimin e dënimit alternativ të dënimit me burgim.

Gjatë vitit 2018 për personat e dyshuar dhe/ose të akuzuar **për kryerjen e veprave penale në fushën e tatimeve, 42 % e kërkesave të prokurorit për caktimin e masave të sigurimit personal, janë për caktimin e masave të sigurimit me arrest,** ndërsa kërkesat e prokurorit për caktimin e llojit dhe masës së dënimit, në masën 29 % janë për caktimin e dënimit me gjobë, **31 % për caktimin e dënimit me burgim** dhe në masën 40 % për caktimin e dënimit alternativ të dënimit me burgim.

Gjatë vitit 2018 për personat e dyshuar dhe/ose të akuzuar **për kryerjen e krimeve në fushën e doganave, 55 % e kërkesave të prokurorit për caktimin e masave të sigurimit personal, janë për caktimin e masave të sigurimit me arrest,** ndërsa kërkesat e prokurorit për caktimin e llojit dhe masës së dënimit, në masën 36 % janë për caktimin e dënimit me gjobë, **24 % për caktimin e dënimit me burgim** dhe në masën 40 % për caktimin e dënimit alternativ të dënimit me burgim.

Gjatë vitit 2018 për personat e dyshuar dhe/ose të akuzuar **për kryerjen e veprave penale kundër mjedisit, 60 % e kërkesave të prokurorit për caktimin e masave të sigurimit personal, janë për caktimin e masave të sigurimit me arrest,** ndërsa kërkesat e prokurorit për caktimin e llojit dhe masës së dënimit, në masën 43 % janë për caktimin e dënimit me

gjobë, në masën 11 % janë për caktimin e dënimit me burgim dhe në masën 46 % për caktimin e dënimit alternativ të dënimit me burgim.

Duhet theksuar se një problem që është konstatuar dhe që është bërë prezent gjatë analizave vjetore të punës së prokurorive, ku prezentë kanë qenë edhe drejtues të institucioneve të tjera, është pamundësia e aplikimit të masës së sigurimit “Arrest në shtëpi”, nën mbikëqyrje elektronike, për shkak se Zyra e Shërbimit të Provës nuk disponon pajisjet për ta bërë këtë masë efektive. Ky lloj i masës së sigurimit është mjaft i rëndë dhe mjaft efektiv dhe nuk i detyron prokurorët dhe gjykatat që të aplikojnë arrestin me burg aty ku nevojat e sigurimit garantohen me arrestin në shtëpi, nën mbikëqyrje elektronike.

Në Prokurorinë e Tiranës është në hetim një çështje që ka për objekt abuzimet që kanë ndodhur gjatë kryerjes së procedurave për blerjen e pajisjeve për mbikëqyrjen elektronike, por një ligj nuk mund të lihet pa u zbatuar, në pritje të përfundimit të një hetimi. Bëhet fjalë për ligjin nr.10 494, dt.20.12.2011 “Për Mbikëqyrjen Elektronike të personave ..”

- **Ndjekja e një politike penale më të butë ndaj të miturve, grave, personave me aftësi të kufizuara që procedohen penalisht, personave që akuzohen për kryerjen e veprave penale me rrezikshmëri të ulët shoqërore, si dhe zhvillimin e hetimeve të shpejta, me qëllim shkurtimin e kohës së hetimit.**

Në zbatim të këtij rekomandimi, në kuadër të zbatimit të Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit, i hyrë në fuqi me datë 1 Janar 2018, si dhe të ndryshimeve të pasqyruara në Kodin e Procedurës Penale përsa i përket viktimave të dhunës, **Prokurori i Përgjithshëm ka miratuar Udhëzimin e Përgjithshëm nr.5, dt.26.10.2018, i shoqëruar me modelet e akteve kryesore që duhen përdorur nga oficerët e policisë gjyqësore dhe prokurorët**, me asistencën e OPDAT-it. Në zbatim edhe të këtij udhëzimi, prokurorët, në çështjet me të mitur në konflikt me ligjin dhe me viktimë apo dëshmitar të mitur kanë garantuar të drejtat dhe liritë e tyre duke u siguruar pjesëmarrja e psikologut gjatë hetimit, si dhe është ruajtur sekreti i informacionit dhe ndalimi i publikimit të akteve hetimore të mbledhura nga policia gjyqësore në ngarkim të tyre. Vlen të përmendet se, nga seksioni për të mitur është pasur kujdes që të procedohet në sa më pak raste me arrestime apo ndalime me subjekt procedural të mitur, duke i kryer hetimet ndaj tyre në gjendje të lirë dhe/ose me masa sigurimi të lehta si “Detyrimi për tu paraqitur në policinë gjyqësore”. Masa e sigurimit “Arrest në burg” është caktuar vetëm në raste specifike dhe të rralla për të mitur që kanë kryer vepra penale të rënda, ose që kanë qenë përsëritës në kryerjen e veprave penale.

Të dhënat tregojnë se janë regjistruar 423 procedime penale dhe 481 të mitur si të pandehur/ persona nën hetim për kryerjen e veprave penale.

Vjedhja e pasurisë përbën grupveprat penale të kryera më së shumti nga të miturit, e konkretisht nga 39 % e të pandehurve të mitur.

Një vepër tjetër penale problematike, për të cilën janë regjistruar 27 % e të pandehurve të mitur është ajo e “Drejtimin të automjeteve në mënyrë të parregullt”.

Rezulton se rreth 15 % e të miturve kanë kryer vepra penale drejtuar personit e për vepra penale lidhur me narkotikët, rezultojnë 4 % e të pandehurve të mitur të regjistruar.

Për veprat penale lidhur me prodhimin dhe mbajtjen pa leje të armëve janë regjistruar 3,5 % e të pandehurve të mitur.

Lidhur me vendimmarrjen e prokurorit për çështjet ku përfshihen të mitur në konflikt me ligjin rezulton se janë dërguar për gjykim 235 çështje dhe janë pushuar 128 çështje, ndër të cilat 76 % janë pushuar duke u caktuar ndaj të miturit masa alternative e shmangies dhe 2 % me ndërmjetësim.

Krahas arritjeve, në zbatimin e parashikimeve ligjore të reja më sipër në praktikë janë hasur dhe problematika që mund të sjellin pasoja për procesin, siç janë mungesa e institucioneve që Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur parashikon për vendosjen e të miturit në një shërbim të specializuar, mungesa e institucioneve që sigurojnë ndihmën juridike falas për të miturit në konflikt me ligjin ose viktimat, rregullimi me akt nënligjor i shpenzimeve procedurale të parapaguara nga shteti në fazën e hetimeve paraprake të kryera nga prokurorët.

Sa i përket ndjekjes penale të veprave penale kundër fëmijëve, martesës e familjes, të parashikuara nga Seksioni IX i Kodit Penal, në vitin 2018 treguesit statistikorë evidentojnë se janë regjistruar 1349 procedime penale dhe 1050 procedime penale janë dërguar për gjykim që krahasuar me vitin 2017 numri i procedimeve të regjistruara për këtë grupveprash penale rezulton me ulje 7,73 %.

Dhuna në familje zë peshën më të lartë të procedimeve në këtë grup veprash, rreth 89,62 %, e konkretisht 1209 procedime penale të regjistruara ose ulje prej 7,71 % krahasuar me vitin 2017.

Prokuroria ka hetuar me shpejtësi e përparësi këtë vepër penale ku konstatohet se 1007 procedime penale janë dërguar në gjykatë.

Sa i përket keqtrajtimit të të miturve, nga të dhënat statistikore vihet re tendenca në rritje prej 30,23 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 124/b i Kodit Penal “Keqtrajtimi i të miturit”, në vitin 2018 në krahasim me vitin 2017, ku janë regjistruar 56 procedime penale dhe janë dërguar 19 procedime penale për gjykim.

- **Thellimi i bashkëpunimit me Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Brendshme, Kontrollin e Lartë të Shtetit, ILDKPKI-në, me qëllim orientimin e një vizioni të përbashkët në politikën shtetërore që duhet të ndiqet në luftën kundër kriminalitetit në tërësi, korrupsionit e krimit të organizuar në veçanti.**

Prokuroria, si organ kushtetues dhe subjekt i rëndësishëm i sistemit të drejtësisë penale, është angazhuar në bashkëpunimin veçanërisht me Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Brendshme në dhënien e kontributit të saj në iniciativat ligjore për përmirësimin e drejtësisë

penale, hartimin e dokumenteve strategjike kombëtare dhe raportime për përmbushjen e prioriteteve e rekomandimeve të Komisionit Europian për Shqipërinë në kuadër të procesit integruar të vendit. Veçojmë të përmendim këtu, angazhimin tonë në procesin screening.

Në kuadër të amendimit të ligjeve të reformës në drejtësi, përfaqësues të Prokurorisë së Përgjithshme janë angazhuar në grupin e punës të ngritur nga Ministria e Drejtësisë, me qëllim dhënien e kontributit për amendimin e rregullave mbi ndihmën e ndërsjellë juridike në fushën penale, përkatësisht në Titullin X të Kodit të Procedurës Penale dhe në ligjin nr.10193 datë 3.12.2009 “*Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale*”. Amendimi i ligjeve në fushën e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar do të përmirësojë dukshëm cilësinë dhe shpejtësinë e ofrimit të ndihmës në këtë fushë. Prokuroria e Përgjithshme gjithashtu është angazhuar në grupin e punës për amendimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe e Irlandës së Veriut për Transferimin e Personave të Dënuar, *ratifikuar me ligjin nr. 98/2013*. Gjithashtu, në kuadrin e procesit të konsultimit të projektligjeve dhe projektvendimeve të Këshillit të Ministrave që zhvillon Ministria e Drejtësisë janë dërguar mendime/komente dhe sugjerime për ndryshime/plotësime edhe të: - projektligjit “Për dhënie amnistie” dhe - projektakteve normative në zbatim të ligjit nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” dhe projektakteve normative në zbatim të Kodit të Drejtësisë për të Mitur.

Përveç sa më sipër marrëdhëniet me Ministrinë e Drejtësisë, në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja gjatë vitit 2018 kanë qenë korrekte, duke i shërbyer punës së secilit institucion dhe homologëve të huaj.

Përfaqësues të Prokurorisë kanë qenë pjesë e grupit të punës të ngritur nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, si për hartimin e projektligjit “*Për zbatimin e masave shtrënguese ndërkombëtare*”, ligj i cili do të rregullojë procedurën e vendosjes, zbatimit dhe shfuqizimit të masave shtrënguese ndërkombëtare (sanksioneve), ku përfshihen dhe çështje/fusha të tjera që mbulojnë Rezolutat e OKB dhe sanksionet autonome të BE, ashtu dhe kemi dhënë kontributet institucionale në përgjigje të kërkesave për informacion për raportimin e tretë kombëtar në kuadër të zbatimit të “Konventës kundër Torturës dhe dënimeve apo trajtimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose degraduese”, etj.

Gjithashtu, në kuadrin e reformës në drejtësi dhe ndryshimeve rrënjësore në sistemin e organizimit dhe të funksionimit të prokurorisë, me synim unifikimin e qëndrimit të prokurorisë për problematika të caktuara, Prokuroria e Përgjithshme në bashkëpunim me Projektin EURALIUS V ka ngritur grupe pune të përbashkëta dhe po punohet për rishikimin dhe përgatitjen e udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm dhe të drejtuesve të prokurorisë, për unifikimin dhe përmirësimin e veprimtarisë organizative dhe funksionale të prokurorisë në të gjitha hallkat dhe nivelet e juridiksionit të përgjithshëm, në përfaqësim me standardet evropiane dhe praktikën e mira të prokurorisë në vendet e Bashkimit Evropian. Gjithashtu, është ngritur grup pune i përbashkët me ekspertët e EURALIUS-it që synon marrjen e ekspertizës dhe eksperiencës ndërkombëtare në çështje që lidhen me bashkëpunimin gjyqësor ndërkombëtar.

- **Të ndjekë në vazhdimësi rastet që referohen në zbatim të ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhe, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, me qëllim sigurimin e pastërtisë së figurës së punonjësve publikë.**

Prokuroria e Përgjithshme në cilësinë e organit që në zbatim të ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe Vendimit të Kuvendit Nr. 17/2016, ka kryer verifikim të thelluar të të kaluarës kriminale të funksionarëve publikë, edhe për vitin 2018, si dhe ka vijuar punën intensivisht në funksion të qëllimit dhe frymës së ligjit. Për këtë qëllim, ka bashkëpunuar me organet ligjzbatuese brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për sigurimin e informacionit të domosdoshëm që garanton verifikim të thelluar dhe për të evidentuar të gjitha rastet kur funksionarit publik duhet t’i ndalohej të ushtrojë funksionet e tij publike.

Gjithashtu, me asistencën e OSBE-së, janë organizuar takime ndërmjet përfaqësuesve të Prokurorisë së Përgjithshme dhe Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, të cilat do të vijojnë dhe në të ardhmen, me synim rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional, evidentimin e problematikave, unifikimin e praktikave, etj. Informacionet e përftuara nga verifikimet e thelluara i janë dërguar institucioneve përkatëse për përgjegjësitë administrative, por në rastet e fshehjes apo deklarimit të rremë nga subjektet për të kaluarën e tyre kriminale, materialet i janë referuar për vlerësim/regjistrim procedimi penal prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë, të cilat raportojnë periodikisht pranë Prokurorisë së Përgjithshme për ecurinë e hetimeve. Me prioritet janë trajtuar dhe rastet kur ka pasur indicie apo kur subjektet sipas ligjit kanë ushtruar të drejtën e nismës për verifikim të të dhënave të formularëve.

Spektori i verifikimit të Integritetit, i ngritur pranë Prokurorisë së Përgjithshme me prokurorë dhe oficerë të policisë gjyqësore, ka krijuar një praktikë dhe vendimmarrje të konsoliduar.

Spektori i Verifikimit të Integritetit pranë Prokurorisë së Përgjithshme pas një eksperience prej rreth 3 vitesh ka krijuar një praktikë dhe vendimmarrje të konsoliduar.

Për vitin 2018 janë administruar **185 raste për verifikim të thelluar (137 subjekte i ka sjellë Departamenti i Administratës Publike, 5 subjekte i ka sjelle KOZ, për 43 subjekte vetëdeklarues ka sjellë kërkesë kuvendi), nga të cilët për 147 raste ka përfunduar procesi.** Nga 147 vendime “Për miratimin e rezultateve të verifikimit”, të cilat u janë njoftuar institucioneve përkatëse, **për 31 subjekte materialet referuese i janë dërguar për kompetence prokurorive pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm pasi ka rezultuar, se këta shtetas kanë deklaruar të dhëna të pavërteta/rreme në formular,** duke konsumuar veprën penale të “Falsifikimit të vulave, të stampave ose formularëve” parashikuar nga neni 190 i Kodit Penal.

Kategoritë e zyrtarëve të verifikuar kanë qenë: nëpunës të nivelit ekzekutiv 27, nëpunës të nivelit të mesëm drejtues 45, nëpunës të nivelit drejtues 30, zyrtarë të lartë 45. Për 44 zyrtarë të lartë është konstatuar se nuk përfshihen në sferën e ndalimeve, ndërsa për 1 prej tyre ka rezultuar se përfshihet në fushën e zbatimit të ligjit.

Prokurori i Përgjithshëm në zbatim të rekomandimeve dhe problematikave të konstatuara, ka nxjerrë udhëzimet e përgjithshme (detajuar në raportin vjetor) dhe ka kërkuar informacione nga drejtuesit e prokurorive lidhur me masat e marra në zbatim të kompetencave ligjore të tyre, si për nxjerrjen e udhëzimeve të përgjithshme për të lehtësuar zbatimin e udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm, ashtu dhe për nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme për prokurorët për çështje konkrete, me synim, që të garantojnë pavarësinë e prokurorit në ushtrimin e funksioneve dhe të sigurojnë efikasitetin, ligjshmërinë e transparencën në veprimtarinë e prokurorive që drejtojnë.

Përveç sa më sipër, prokuroria, si organ kushtetues dhe subjekt i rëndësishëm i sistemit të drejtësisë penale, është angazhuar në bashkëpunimin veçanërisht me Kuvendin, Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Brendshme në dhënien e kontributit të saj në iniciativat ligjore për përmirësimin e drejtësisë penale, hartimin e dokumenteve strategjike kombëtare dhe raportime për përmbushjen e prioriteteve e rekomandimeve të Komisionit Europian për Shqipërinë në kuadër të procesit integruar të vendit.

Si konkluzion, referuar numrit, llojeve, shtrirjes territoriale, intensitetit dhe formave të kriminalitetit dhe masave të tjera të analizuara më sipër dhe në mënyrë më të hollësishme në Raport, organi i prokurorisë duket se i ka përmbushur detyrat Kushtetuese e ligjore dhe ka zbatuar Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë, rekomandimet e Këshillit të Ministrave, rekomandimet e Komisionit Evropian, prioritetet kyçe të shtetit shqiptar në kuadër të procesit të integritetit dhe strategjinë afatmesme të prokurorisë 2018-2020, në luftën kundër krimit të organizuar e korrupsionit dhe kundër fenomeneve kriminale tradicionale, krimi ekonomik dhe krimet e tjera, duke ndihmuar e kontribuar në forcimin e rendit dhe të sigurisë publike dhe duke siguruar një procedim të drejtë dhe garantuar liritë personale dhe të drejtat e interesat e ligjshme të shtetasve, si subjekte, ashtu dhe viktimat në procesin penal.

Me synim përmirësimin dhe rritjen e efektivitetit të ndjekjes penale, ngritjes dhe përfaqësimit të çështjes/akuzës në gjyq për krime të rënda dhe me tendencë në rritje, si dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të individit në procesin penal, prioritetet e prokurorisë për vitin 2019, janë si më poshtë:

i) Lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, nëpërmjet:

- Rritjes së hetimeve proaktive dhe teknikave speciale të hetimit.
- Hetimeve pasurore dhe rritjes së numrit të asetëve të sekuestruara dhe të konfiskuara.
- Forcimit të bashkëpunimit me agjencitë ligj zbatuese vendase dhe të huaja.
- Cilësisë hetimore në rritje.
- Ashpërsimit të politikës penale në drejtim të masave të sigurimit dhe atyre të dënimit.
- Trajnimeve të prokurorëve dhe të oficerëve të policisë gjyqësore që hetojnë veprat penale kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

ii) Garantimi i pavarësisë së prokurorëve, integritetit dhe profesionalizmit të tyre në ushtrimin e funksioneve Kushtetuese e ligjore. Prokurorët duhet të kenë kapacitetin, mbështetjen dhe mjetet e nevojshme për të ushtruar funksionet e ngarkuara me ligj.

-Në kuadrin e reformës në drejtësi, zbatimi i ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” kërkon marrjen e masave të nevojshme për krijimin e kushteve dhe shtimin e kapaciteteve njerëzore mbështetëse në prokuroritë e të gjitha niveleve të juridiksionit të përgjithshëm.

-Në kuadrin e procesit të rivlerësimit kalimtarë të prokurorëve janë krijuar (*aktualisht 21 prokuror janë shkarkuar nga detyra dhe/ose janë të pezulluar*) dhe po krijohen mungesa të prokurorëve në të gjitha nivelet e prokurorisë, dhe në mungesë të planifikimit të magjistratëve që nxjerr Shkolla e Magjistraturës deri në vitin 2021, për të përballuar ngarkesën në rritje në veprimtarinë e prokurorëve që ushtrojnë funksionet, krahas masave në drejtim të forcimit të kapaciteteve dhe ndryshimeve strukturore në sistemin e prokurorisë, shtrohet si nevojë emergjente marrja e masave për shtimin e numrit të oficerëve të policisë gjyqësore dhe të numrit në administratën ndihmëse/mbështetëse të prokurorëve në prokuroritë e të gjitha niveleve të juridiksionit të përgjithshëm.

-Ndërkohë, në bashkëpunim me KLP dhe Shkollën e Magjistraturës kërkohet të merren masat e duhura, për të planifikuar në kohë zëvendësimin e prokurorëve të shkarkuar nga detyra me magjistrat/prokuror sipas ligjit, me synim për të shmangur rritjen progresive të numrit organik të prokurorëve që i mungojnë sistemit të prokurorisë në të tre nivelet pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm

-Nuk mund të pretendohet për të rritur efektivitetin e ndjekjes penale dhe për të pasur një prokurori efikase/fortë me numër prokurorësh të pamjaftueshëm, për të përmbushur detyrimet kushtetuese dhe ligjore të tyre.

iii) Rritja dhe forcimi i bashkërendimit ndërinstitucional i të gjithë aktorëve të sistemit të drejtësisë penale, për të rritur efikasitetin e sistemit të drejtësisë penale, si kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar që përbëjnë sfidën kryesore në prag të organizimit dhe funksionimit të SPAK-ut, ashtu dhe kundër fenomeneve kriminale, tradicionale, siç janë vrasjet për hakmarrje e gjakmarrje, etj., krimi ekonomik dhe krimet e tjera të rënda me tendenca në rritje që cenojnë rendin dhe sigurinë publike.

-Forcimi dhe rritja e mëtejshme e bashkëpunimit ndërinstitucional me agjencitë ligjzbatuese brenda dhe jashtë vendit, për thellimin dhe intensifikimin e hetimeve proaktive dhe përdorimin e mjeteve të posaçme të hetimeve në funksion të zbulimit dhe goditjes të veprimtarisë, si të krimit të organizuar dhe ekonomik brenda vendit dhe të lidhjeve të tij jashtë vendit, ashtu dhe të korrupsionit në nivele qendrore e vendore dhe lidhjet e tij me krimin, duke sekuestruar pasuritë dhe produktet e veprimtarisë kriminale të tyre.

-Rritja e bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë në gjitha fushat e bashkëpunimit ndërgjyqësor me autoritetet gjyqësore të huaja, si për të shkëmbyer informacion lidhur me

veprimtaritë e grupeve kriminale që shtrijnë aktivitetin me lidhjet e tyre jashtë vendit, ashtu dhe për krijimin e skuadrave të përbashkëta hetimore për hetimin dhe goditjen e veprimtarisë së tyre brenda dhe jashtë vendit.

-Në kuadrin e bashkëpunimit me aktorët e tjerë të sistemit të drejtësisë penale, situata aktuale vlerësojmë se kërkon edhe hartimin e strategjive të një politike procedimi dhe dënimi më të studiuar dhe më të unifikuar, si në nivel rrethi gjyqësor, në nivel apeli dhe në shkallë vendi, duke garantuar respektimin e parimeve për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

iv) **Ngritja e strukturave të posaçme pranë prokurorive të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm dhe forcimin e kapaciteteve të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore** për ushtrimin efikas të ndjekjes penale dhe hetimit pasuror për çështjet që do jenë në kompetencë lëndore e tyre me krijimin e SPAK-ut.

v) Marrja e masave për të adresuar e rekomanduar zgjidhje lidhur me ngarkesën që krijohet në prokurori nga referimet jo cilësore mbi kërkesat e viktimës akuzuese, të cilat proceduralisht duhet t'i drejtohen drejtpërdrejt gjykatës.

vi) Rritja e përdorimit të instituteve procedurale të reja si urdhri penal, marrëveshja e fajësisë, gjykimi i drejtpërdrejtë në mënyrë më efektive për t'i shërbyer shpejtësisë së procesit dhe qëllimit të ligjit penal.

vii) **Forcimi i kapaciteteve nëpërmjet trajnimeve të prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore dhe nëpunësve civil në prokurori** me qëllimin rritjen e mëtejshme të aftësive profesionale të tyre.

viii) **Nxjerrja e rregulloreve dhe udhëzimeve të përgjithshme me natyrë administrative dhe procedurale, në bashkëpunim me misionin/projektin EURALIUS V, me synim qartësimin e kuptimit dhe zbatimit në praktikë të kuadrit ligjor përkatës dhe mbikëqyrja e zbatimit tyre**, si më poshtë:

-Rregullorja standarde për organizimin dhe funksionimin e prokurorive me juridiksion të përgjithshëm, për të siguruar efikasitet në organizimin, drejtimin dhe kontrollin e punës në çdo prokurori.

-Udhëzimi “*Për garantimin e pavarësisë së prokurorit, marrëdhëniet e tij me drejtuesin e prokurorisë dhe informimin në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm*”, për të unifikuar, të drejtat dhe detyrimet e prokurorit në ushtrimin e funksioneve, marrëdhëniet e tij me drejtuesin e prokurorisë si prokuror më i lartë dhe informimin e koordinimin në veprimtarinë e prokurorisë, si dhe për të siguruar mbikëqyrjen, efikasitetin, ligjshmërinë e transparencën në veprimtarinë e prokurorisë si organ kushtetues i pavarur.

-Udhëzimi “*Për informimin e publikut lidhur me hetimin dhe ndjekjen penale të veprave penale*”, për të unifikuar mënyrën e shpërndarjes së informacionit për publikun lidhur me

hetimin dhe ndjekjen penale të veprave penale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, si dhe për të garantuar ruajtjen e sekretit të hetimeve dhe ndalimin e publikimit të akteve procedurale penale nga prokurori dhe/ose oficerët e policisë gjyqësore.

-Udhëzimi për zbatimin e rekomandimeve të Këshillit të Ministrave për luftën kundër kriminalitetit, si dhe për të unifikuar dhe orientuar prokurorët në kërkesat për caktimin e masave të sigurimit personal e pasuror dhe për caktimin e masave të dënimit, si në ashpërsimin e politikës së dënimit për disa grup vepra penale dhe krime të rënda të evidentuara me tendencë në rritje, ashtu dhe për zbutjen e politikës së dënimit për disa grup vepra penale të lehta me tendencë në ulje për vitin 2018.

-Udhëzimi për funksionimin e policisë gjyqësore të përfshirë në hetime dhe koordinimin e punës ndërmjet tyre dhe prokurorive.

-Udhëzimi për ekzekutimin e vendimeve penale.

ix) Në bashkëpunim me strukturat e reja që ligji parashikon ngritjen e tyre, implementimin me përgjegjësi dhe efikasitet të kuadrit të pritsëm ligjor për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore.

-Sigurimin e bashkëpunimit, koordinimit, shkëmbimit të informacionit dhe mbikëqyrjes së veprimtarisë, me të gjitha institucionet dhe agjencitë ligj zbatuese që kanë shërbime të policisë gjyqësore.

x) **Garantimi i respektimit të të drejtave të njeriut në të gjitha fazat e ndjekjes penale,** nëpërmjet mbikëqyrjes nga prokuroria të respektimit të të drejtave dhe lirive Kushtetuese dhe në ligj të shtetasve, me synim për të siguruar mbrojtjen e lirive dhe drejtën e trajtimit njerëzor dhe të respektimit të dinjitetit të personave të arrestuar, ndaluar, paraburgosur apo dënuar.

xi) **Përdorimi me efektivitet i fondeve buxhetore për përmirësimin e infrastrukturës në prokurori** dhe për sigurimin e aksesit të shtetasve në shërbimin e prokurorisë.

Ju faleminderit!

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

Arta MARKU

